

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	E drejta financiare
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I- Semestri II
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Caktohet me vonë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Armand Krasniqi, Msc. Diamanta Sojeva
Detajet kontaktuese:	<u>armand.krasniqi@uni-pr.edu</u> <u>diamanta.sojeva@uni-pr.edu</u>
Përshkrimi i lëndës	
	<p>E drejta financiare studijon veprimtaritë financiare të shtetit dhe personave tjerë juridik të së drejtës publike, kolektivitetëve juridiko-publike të cilave me ligj u është besuar të kryejnë veprimtari të këtilla.</p> <p>Mekanizmi i mbledhjes dhe shpenzimit të mjeteve financiare si dhe harmonizimi dhe planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në kuader të ekonomisë financiare fillon mbi bazën e institucioneve të financave publike.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kjo lëndë për studentët ofron njohuri juridiko-financiare shumë të rëndësishme mbi institucionet kryesore të financave publike përmes njohjes me teorinë mbi institucionet financiare si dhe praktikën e funksionimit të institucioneve financiare. Shkenca mbi Financat dhe e Drejta Financiare jep përgjigje për tri çështje madhore; si, sa dhe prej kujt duhet të mbidhen mjetet financiare për financimin e shpenzimeve shtetërore, si duhet bërë shpërndarjen e mjeteve financiare në disa subjekte dhe për disa qëllime, si dhe si të shpenzohet këto mjete ashtu që të realizohen në mënyrë sa më optimale detyrat nga kompetencat e shtetit.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Që të njeh kategorit themelore të financave publike nga dimensionet juridiko-financiar; • Do të jetë në gjendje të përshkruan funksionimin e marrëdhënieve juridiko-

	financiare; <ul style="list-style-type: none"> • Do të jetë në gjendje që të bëj krahasimin e institucioneve financiare; • Do të jete në gjendje të zhvillon iden mbi menyrat e financimit të shpenzimeve publike.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet, prezantimet ,etj	-	-	-
Totali			100

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjerata interaktive: Bashkëbisedim. Duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me qështjët e ndryshme tematike,</p> <p>Punime seminarike: Aktivitete të studentëve. Studentët mund të përcaktohen për studimin e ndonjë teme apo punimi seminarik. Para fillimit të punës së tyre atyre ju ofrohën udhëzimet elementare, ndërsa pas përfundimit ju ofrohët mundësija e prezentimit të punimeve të tyre para studenteve te tjere. Pas prezentimit të ketyre seminareve</p>
-------------------------------------	--

	<p>zhvillohet debat interaktiv lidhur me temat e shtjelluara dhe në fund behet vlersimi i punimit.</p> <p>Puna grupore: Debat shkencorë. Gjatë trajtimit te temave te ndryshme, studentët mund të ndahen ne dy ose me shumë grupe, më qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore.</p> <p>Metodat e ligjerimit: Zakonisht do të aplikohën metoda bashkëkohore të ligjerimit, të cilat praktikohën në Universitetët e ndryshme evropiane: prezentimi i temes përmes Power Point, raste studimi dhe detyra mësimore – studimore lidhur me temen e ligjeruar. Në disa raste atyre do të prezantohën edhe ligjerata autentike nga universitetet e ndryshme perendimore.</p>
Metoda e vlerësimit:	
<p>Vlerësimi ne %</p> <p>91 – 100% = nota 10</p> <p>81 – 90 % = nota 9</p> <p>71 – 80% = nota 8</p> <p>61 – 71% = nota 7</p> <p>51 – 60% = nota 6</p> <p>0 – 50% = nota 5</p>	<p>Vijimi i ligjëratave = 0%</p> <p>Ese / prezantim = 10%</p> <p>Punimi seminarit = 0 %</p> <p>Testi i parë = 45%</p> <p>Testi i dytë = 45%</p> <p>Pjesëmarrja ne ushtrime = 0%</p> <p>Puna grupore dhe rasti i studimit = 0%</p>
<p>Vlerësimi i studentëve në masën më të madh do të bëhet me shkrim nëpërmjet të testeve. Testi i parë do të ketë rreth 70% të pyetje opsione dhe 30 % ese ndërkaq testi i dytë 50 % pyetje opsionale dhe 50% pyetje ese.</p>	
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dr. Bedri Peci: SHKENCA MBI FINANCAT DHE E DREJTAT FINANCIARE, Prishtinë 2017 2. Dr. Drita Konxheli –Radoniqi: Financat Publike, Prishtinë 2019 3. Dr. Sabri Kadriu: Financat publike , Prishtinë 2012 4. Genta Tafa (Bunga):Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare, Tiranë 2009 5. Dr. Sabahudin Komoni: Financat Publike, Prishtinë 2008 6. Gani Asllani & Vehbi Imeri. E derjta fiskale dhe ndertimi i sistmit tatimor. 2016. Prishtinë;
Literatura shtesë e preferuar:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Materiale nga librat tjera dhe nga interneti që i kushtohet financave dhe drejtës financiare apo

	<p>financave publike ne çdo gjuhe;</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Ligji mbi menaxhimin e financave publike (i Kosovës dhe i Shqipërisë); 3. Kodin doganor dhe të akcizave në Kosovë; 4. Ligji i buxhetit të Kosovës; 5. Ligji Nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së auditorit të përgjithshëm dhe Zyrës së auditimit të Kosovës; 6. Ligji i tatimit të ardhurave personale, etj 7. Legjislacioni për tatimet; 8. Menaxhimi i shpenzimeve publike, Tiranë, 2004;
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i programit Hyrje në shkencën mbi financat dhe drejtën financiare
<i>Java e dytë:</i>	Kuptimi i përgjithshëm i nevojave publike dhe klasifikimi i tyre
<i>Java e tretë:</i>	Të hyrat publike në teorinë dhe praktiken financiare si dhe sistemi dhe politika e formimit të të hyrave publike.
<i>Java e katërt:</i>	Përkufizimi dhe rëndësia e tatimeve – teoria dhe praktika financiare
<i>Java e pestë:</i>	Ndarja e tatimeve në teorinë dhe praktiken financiare
<i>Java e gjashtë:</i>	Kuptimi, rëndësia dhe përkufizimi i taksave dhe kontributeve
<i>Java e shtatë</i>	Testi i parë <i>Detaje teknike dhe kohën specifike të testit informatat merren më vonë në kohën e ligjëratave ose ushtrimeve</i>
<i>Java e tetë:</i>	Huat Publike në teorinë dhe praktiken financiare Shpenzimet publike në teorinë dhe praktiken financiare
<i>Java e nëntë:</i>	Ndarja e shpenzimeve publike
<i>Java e dhjetë:</i>	Kuptimi, rëndësia dhe përkufizimi i buxhetit në teorinë dhe praktiken financiare
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Parimet buxhetore
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Procedura buxhetore
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Kontrolli i buxhetit në teorinë dhe praktiken buxhetore
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Marrdhëniet financiare në mes organeve qendrore dhe lokale. Sistemi dhe politika e financimit publik në Kosovë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.